



## Zhvillimet e standardeve të KPT-së gjatë burgosjes

*Pjesë nga raporti i 11-të i Përgjithshëm,  
publikuar në vitin 2001*

### Marrëdhëniet midis personelit dhe të ndaluarve

26. Guri themelor i një sistemi për vuajtjen e dënimit me fytyrë njerëzore do të jetë gjithmonë një personal i punësuar me kujdes dhe i formuar, që di të sillet si duhet në marrëdhëniet me të ndaluarit dhe se e koncepton punën e tij më tepër si një prirje sesa një punë të thjeshtë. Aftësia për të krijuar marrëdhënie të mira me të ndaluarit duhet të njihet si një nga elementët kryesorë të kësaj prirje.

Fatkeqësisht, KPT-ja vëren shpesh se marrëdhëniet midis personelit dhe të dënuarve janë formale dhe të distancuara, personeli mban sjellje shumë të rreptë kundrejt të ndaluarve duke e konsideruar komunikimin me fjalë si një aspekt anësor të punës së tyre. Praktikrat e mëposhtme, shpeshherë të vërejtura nga KPT-ja, janë tregues të këtij qëndrimi: të detyrosht të ndaluarit të kthehen me fytyrë nga muri duke pritur që personeli i burgut të kujdeset për ta ose kur vizitorët kalojnë; t'i urdhërosht të ndaluarit të ulin kokën dhe t'i lidhin duart prapa kurrizit kur lëvizin në institucion; rojet që tundin shkopin e tyre në mënyrë të dukshme biles dhe provokuese. Praktika të tilla nuk janë të nevojshme përse i përket sigurisë dhe nuk ndihmojnë aspak në zhvillimin e marrëdhënieve të mira midis personelit dhe të dënuarve.

Profesionalizmi i vërtetë i personelit të burgut kërkon që ai të jetë i aftë të trajtojë të ndaluarit në mënyrë të denjë dhe njerëzore por duke qënë i kujdesshëm për problemet e rendit dhe të sigurimit. Lidhur me këtë, administrata e burgut duhet ta nxisë personelin që të tregojë një lloj besimi dhe të niset me idenë se të ndaluarit janë të prirur për t'u sjellë në mënyrë korrekte. Zhvillimi marrëdhënieve konstruktive dhe pozitive midis personelit dhe të ndaluarve jo vetëm do të kufizojë rrezikun e keqtrajtimit, por dhe do të forcojë kontrollin dhe sigurinë. Kjo do ta bëjë punën e personelit të burgut më të dobishme.

Garantimi i marrëdhënieve pozitive midis personelit dhe të ndaluarve do të varet gjithashtu nga prania, në çdo moment, e një personeli me numër të mjaftueshëm në zonat e mbikqyrjes dhe vendet e veprimtarive të shpeshta të të ndaluarve. Delegacionet e KPT-së konstatojnë shpesh se kjo gjë nuk ndodh. Personeli i pakët në numër dhe/ose sistemet e veçanta të pranisë të personelit, që zvogëlojnë mundësitë e kontakteve të drejtpërdrejta me të ndaluarit, do të pengojnë domosdoshmërisht zhvillimin e marrëdhënieve të mira: në mënyrë më të përgjithshme, ata do të krijojnë një mjedis që nuk do ta ofrojë sigurinë e duhur si për personelin ashtu dhe për të ndaluarit.

Duhet parë gjithashtu se, kur efektivat e personelit janë të papërshtatshme, një numër i rëndësishëm orësh plotësuese mund të nevojitet me qëllim mbajtjen e një niveli minimal sigurie dhe

zhvillimin e programeve të veprimtarive në institucion. Një gjendje e tillë mund të shkaktojë lehtësisht një nivel të rëndësishëm stresi për personelin dhe lodhje profesionale të parakohshme, një situatë që rrezikon acarimin e tensionit të brendshëm të çdo mjedisi burgimi.

## **Dhuna mes të ndaluarve**

27. Detyrimi për të marrë në ngarkim të ndaluarit që i takon personelit të burgut përfshin përgjegjësinë për t'i mbrojtur nga të ndaluarit e tjerë të cilët mund t'i shkaktonin dëme. Në fakt, incidentet e dhunshme midis të ndaluarve janë të shpeshta në vendet e vuajtjes së dënimit; ata përfshijnë një numër të madh fenomenesh, që nga format e stërholluara të kërcënimeve në friksime të dukshme e deri në agresione fizike të rënda.

Një strategji efikase kundër akteve të dhunës midis të ndaluarve kërkon që personeli i burgut të jetë në gjendje, përfshirë këtu efektivat, të ushtrojë ashtu si duhet autoritetin e tij dhe funksionin e mbikqyrësit. Personeli i burgut duhet të jetë i kujdesshëm kundrejt shenjave të trazirave dhe të jetë njëherësh i vendosur dhe i formuar në mënyrën e duhur për të ndërhyrë kur kjo është e nevojshme. Ekzistenca e marrëdhënieve pozitive midis personelit dhe të ndaluarve, bazuar mbi nocionet e sigurisë së ndalimit dhe të marrjes në ngarkim të të ndaluarve, përbën një faktor thelbësor në këtë kontekst; kjo do të varet gjerësisht nga fakti që personeli ka kualifikime të duhura në fushën e komunikimit ndërpersonal. Përveç kësaj, drejtoria duhet të jetë e gatshme që të mbrojë plotësisht personelin në ushtrimin e autoritetit të tij. Masa të sigurisë të veçantë, të përshtatura me karakteristikat e veçanta të situatës (përfshirë këtu procedurat efikase të kërkimit) mund të vendosen fare mirë; megjithatë, këto masa mund të shërbejnë vetëm si një mbështetje për detyrat thelbësore të sigurisë të lartëpërmendur. Për më tepër, sistemi i vuajtjes së dënimit duhet të trajtojë çështjen e klasifikimit dhe të ndarjes së përshtatshme të të ndaluarve.

Të ndaluarit e dyshuar ose të dënuar për shkelje të karakterit seksual janë veçanërisht të ekspozuar ndaj një rreziku të madh agresioni nga ana e të ndaluarve të tjerë. Përballimi i këtyre veprimeve do të përfaqësojë gjithmonë një sfidë për t'u fituar. Politika e ndarjes të të dënuarve nga pjesa tjetër e personave që iu është hequr liria konsiderohet shpesh si një zgjidhje e problemit. Megjithatë të ndaluarve mund t'i kushtojë shtrenjtë për sigurinë e tyre, duke u kufizuar programet e aktiviteteve që janë shumë më të kufizuara se regjimi i zakonshëm. Një përjasje tjetër ka të bëjë me politikën e shpërndarjes të të ndaluarve në fjalë brenda institucionit të vuajtjes së dënimit. Më qëllim që një përjasje e tillë t'ia dali mbanë, mjedisi i nevojshëm për një internim efektiv të këtyre të ndaluarve në qendra ndalimi të zakonshme duhet të jetë i garantuar; në veçanti, personeli i burgut duhet të jetë tepër i angazhuar për të dënuar çdo manifestim kundërshtimi ose persekutimi ndaj këtyre të ndaluarve. Një përjasje e tretë mund të ketë të bëjë me transferimin e të ndaluarve drejt një institucioni tjetër, të shoqëruar me masa që synojnë fshehjen e karakterit të shkeljeve të tyre penale. Secila nga këto politika paraqet të mira dhe të këqija, dhe KPT-ja nuk tenton të shprehet në favor të kësaj ose asaj përjasje të veçantë. Në fakt, përcaktimi i politikës që do të vihet në jetë do të varet nga rrethanat e veçanta që do të rrethojnë çdo rast.

## **Mbipopullimi i burgut**

28. Fenomeni i mbipopullimit të burgut vazhdon t'i shkatërrojë sistemet e vuajtjes së dënimit në Europë dhe të minojë në mënyrë të rëndë tentativat e bëra për përmirësimin e kushteve të ndalimit. Pasojat negative të mbipopullimit të burgut janë vënë në dukje në raportet e përgjithshme paraardhëse të veprimtarive.<sup>1</sup> Me shtrirjen e fushës së veprimit në kontinentin europian, KPT-ja është gjendur përballë përqindjeve të mëdha të burgosjeve dhe, si pasojë, një mbipopullim të rëndë

---

<sup>1</sup> Raporti i 2-të i Përgjithshëm - CPT/Inf (92) 3. paragrafi 4, dhe Raporti i 7-të i Përgjithshëm - CPT/Inf (97) 10, paragrafet 12 në 15.

të burgut. Fakti që një Shtet burgos një numër kaq të madh shtetasish nuk mund të shpjegohet në mënyrë të bindshme nga një përqindje e madhe kriminaliteti; sjellja e përgjithshme e anëtarëve të shërbimeve të ngarkuar me zbatimin e ligjeve dhe autoritetet gjyqësore pjesërisht duhet të jenë pjesërisht të përgjegjshëm.

Në rrethana të tilla, të investosh shuma të konsiderueshme në zonën e vendit të vuajtjes së dënimit nuk përbën një zgjidhje. Më mirë është të rishikohen legjislacionet dhe praktikat në fuqi në fushën e paraburgosjes dhe të dhënies së dënimeve, si dhe tërësia e dënimeve që nuk kërkojnë heqjen e lirisë që dhe janë të disponueshme. Ky është pikërisht qëndrimi i parashikuar nga Rekomandimi N° R (99) 22 i Komitetit të Ministrave lidhur me mbipopullimin e burgjeve. KPT-ja shpreson vërtetë që parimet e shprehura në këtë tekst thelbësor të jenë efektivisht të zbatueshme nga Shtetet anëtare; zbatimi i këtij Rekomandimi meriton që të mbikqyret rreptësisht nga Këshilli i Europës.

## **Fjetore të mëdha**

29. Në disa Shtete të vizituara nga KPT-ja, dhe sidomos në Europën Qendrore dhe lindore, të ndaluarit janë të sistemuar në fjetore të mëdha që përfshijnë tërësisht ose pjesërisht instalimet që përdoren përditë prej tyre, si zonat e fjetjes dhe të ndenjes si dhe instalimet sanitare. KPT-ja është kundër mënyrave të tilla të strehimit në burgje të mbyllura, dhe kundërshtimet e saj janë më të rrepta, atëherë kur, si ndodh shpesh, këto fjetore strehojnë të ndaluar në hapsira tepër të vogla dhe të dëmshme. Natyrisht që disa faktorë ndër të cilët dhe ata që kanë të bëjnë me kulturën, në disa Shtete, mund të bëjnë më të preferueshëm vendet kolektive të ndalimit sesa qelitë individuale. Megjithatë nuk ka gjë për të qënë në favor, - dhe ka shumë për të qënë në disfavor – të një sistemi i cili bën që të jetojnë dhe të flenë bashkë në të njëjtën fjetore dhjetra e dhjetra të ndaluar.

Fjetoret e mëdha në mënyrë të paevitueshme sjellin mungesën e intimitetit në jetën e përditshme të të ndaluarve. Për më tepër, rreziku i frikësimit dhe i dhunës rritet. Të tilla mënyra strehimi mund të ndihmojnë zhvillimin e nën-kulturave kriminale dhe mbajtjen e lidhjeve të organizatave kriminale. Ato mund vështirësojnë kontrollin efektiv nga personeli, bile dhe mund ta bëjnë atë dhe të pamundur; në veçanti, në rast trazirash në burg, është tepër e vështirë të ndalosh ndërhyrjet e jashtme që shkaktojnë një përdorim të konsiderueshëm të forcës. Me të tilla mënyra, një ndarje e përshtatshme e të dënuarve, bazuar në një vlerësim rast pas rasti të rreziqeve dhe të nevojave, bëhet gjithashtu një detyrë pothuajse e pamundur. Të gjitha këto probleme rriten kur numri i të ndaluarve kalon numrin e arsyeshëm të të strehuarve; për më tepër, në një situatë të tillë, ngarkesa e tepërt e përdorimit të instalimeve të përbashkëta si lavamanet, banjat si dhe ajrosja e pamjaftueshme për një numër kaq të madh njerëzish do të çojë në kushte burgimi të këqia.

KPT-ja duhet të theksojë se kalimi nga fjetore të mëdha në vende më të vogla duhet të shoqërohet me masa që synojnë garantimin që të ndaluarit të kalojnë një pjesë të arsyeshme të ditës së tyre jashtë qelisë, duke u marrë me aktivitete të ndryshme motivuese.

## **Mundësia për të dalë në dritën e ditës dhe për të marrë ajër të pastër**

30. KPT-ja vë re shpesh ekzistencën e masave të tillë si grilat, kafaz dritarësh ose pllaka metalike të vendosura përpara dritareve të qelive të cilat ia heqin dritën të dënuarve dhe pengojnë që ajri i pastër të futet në ambiente. Këto instalime hasen shpesh sidomos në vendet e paraburgimit. KPT-ja pranon plotësisht që masa të veçanta sigurie, të parashikuara për parandalimin e rrezikut të përplasjes dhe/ose të veprimtarive kriminale, mund të jenë të nevojshme për disa të ndaluar. Megjithatë masa të kësaj natyre duhet të përbëjnë përjashtimin dhe jo rregullën. Kjo gjë supozon që autoritetet kompetente të marrin në shqyrtim rastin e çdo të ndaluarit, me qëllim për të përcaktuar nëse masat e veçanta të sigurisë justifikohen në të vërtetë në rastin e tij. Për më tepër, dhe kur masa

të tilla nevojiten, ato nuk duhet kurrë që t'ia heqin dritën e diellit apo ajrin e pastër të ndaluarve. Këtu bëhet fjalë për kushte thelbësore të jetës, të cilat çdo i ndaluar ka të drejtë t'i gëzojë; për më tepër mungesa e këtyre elementëve krijon kushte të favorshme për përhapjen e sëmundjeve dhe, veçanërisht, të tuberkulozit.

KPT-ja pranon se krijimi i kushteve normale të jetesës në institucionet e vuajtjes së dënimit mund të jetë shumë i kushtueshëm dhe përmirësimet në shumë vende kufizohen nga mungesa e fondeve. Megjithatë, heqja e instalimeve që bllokojnë dritaret e ambjenteve për strehimin e të dënuarve (dhe instalimi në rast se është i nevojshëm i masave të tjera me formë të përshtatshme) nuk duhet të shkaktojë investime shumë të rënda, dhe, në të njëjtën kohë, do të kishte efekte tepër të dobishme për të gjithë personat e interesuar.

## **Sëmundjet ngjitëse**

31. Përhapja e sëmundjeve ngjitëse dhe, sidomos, i tuberkulozit, i hepatitit dhe i SIDA-s është bërë një shqetësim madhor për shëndetin publik në disa vende europiane. Megjithëse këto sëmundje prekin edhe popullsinë në përgjithësi, ato janë kthyer në një problem dramatik për disa sisteme të vuajtjes së dënimit. Në lidhje me këtë KPT-ja, shpeshherë, ka qënë e detyruar të paraqesë shqetësime serioze për papërshtatshmërinë e masave të zbatuara për trajtimin e këtij problemi. Përveç kësaj, shpeshherë, është vënë re se kushtet materiale në të cilat të ndaluarit ishin strehuar veçse mund të favorizonin përhapjen e këtyre sëmundjeve.

KPT-ja pranon se në një periudhë me vështirësi ekonomike – si ato që hasin shumë prej vendeve të vizituara nga KPT-ja – duhen bërë disa sakrifica, përfshirë dhe në institucionet e vuajtjes së dënimit. Por, cilatdo qofshin vështirësitë e hasura në një kohë të caktuar, fakti i privimit të një personi nga liria e tij nënkupton gjithmonë detyrimin e marrjes në ngarkim; ky detyrim kërkon metoda efikase parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi. Respekti i këtij detyrimi nga autoritetet publike është akoma më i rëndësishëm kur bëhet fjalë për trajtimin e sëmundjeve që rrezikojnë të jenë fatale.

Përdorimi i metodave aktuale të diagnostikimit, furnizimi i rregullt me ilaçe dhe produkte të tjera të nevojshme, disponueshmëria e personelit për t'u kujdesur që të ndaluarit të marrin ilaçe të dhëna në doza dhe intervale të duhura, si dhe nëse nevojitet, regjime ushqimore të nevojshme, përbëjnë elemente thelbësore të një strategjie efikase që kanë si synim luftimin e sëmundjeve të sipërpërmendura dhe përkujdesin e duhur për të ndaluarit e interesuar. Gjithashtu, kushtet materiale të strehimit të të ndaluarve të prekur nga sëmundje ngjitëse duhet të jenë të përshtatshme me gjendjen e tyre shëndetësore; përveç dritës së diellit dhe një ajrosje të mirë, duhen kushte higjienike të kënaqshme dhe nuk duhet të ketë mbipopullim.

Për më tepër, të ndaluarit e interesuar nuk duhet të ndahen nga pjesa tjetër e të ndaluarve, përveç se kur kjo masë është tepër e nevojshme për arsye mjeksore ose arsye të tjera. Në lidhje me këtë KPT-ja nënvizon në mënyrë të veçantë se nuk ka justifikim mjeksor për diskriminimin e të ndaluarit për arsyen e vetme se ai është seropozitiv me VIH.

Për të shuar çdo keqkuptim lidhur me këto çështje, autoritetet shtetërore duhet të marrin masa që një program i kompletuar edukimi lidhur me sëmundjet ngjitëse të zbatohet si ndaj të ndaluarve po ashtu dhe ndaj personelit. Një program i tillë duhet të trajtojë mënyrat e transmetimit dhe të mbrojtjes si dhe zbatimin e masave parandaluese të përshtatshme. Është e domosdoshme të theksohen rreziqet e transmetimit të SIDA-s dhe të hepatiteve B/C me rrugë seksuale dhe toksikomani intravenoze, dhe të shpjegohet roli i lëngjeve trupore si vektorë të SIDA-s dhe të viruseve të hepatiteve.

Duhet nënvizuar gjithashtu se përpara çdo testi diagnostikimi – dhe në rast rezultati pozitiv në vijim - duhet të jepen informacionet dhe këshillat e përshtatshme. Përveç kësaj, është e qartë se informacionet lidhur me pacientët duhet të mbulohen nga sekretet mjeksor. Parimisht, çdo ndërhyrje në këtë fushë duhet të bazohet në pranimin e shprehur të personave të interesuar.

Për më tepër, me qëllim që kontrolli i sëmundjeve të sipërpërmendura të jetë efikas, të gjitha ministrat dhe organizmat që punojnë në këtë fushë në një vend të caktuar duhet të kujdesen për një koordinim optimal të përpjekjeve të tyre. Në lidhje me këtë, KPT-ja të vë në dukje se vazhdimësia e mjekimeve duhet të garantohet dhe pas lirimit.<sup>2</sup>

## **Njësitë e sigurisë së lartë**

32. Në të gjitha vendet, ka një numër të caktuar të ndaluarish që konsiderohen sikur paraqesin rreziqe të veçanta në fushën e sigurisë dhe që rrjedhimisht kërkojnë kushte të veçanta ndalimi. Rreziku i lartë që mund të paraqesin këta të ndaluar për sigurinë vlerësohet në bazë të llojit të veprës penale që kanë kryer, nga mënyra se si reagojnë ndaj detyrave të jetës në burg ose të profilit të tyre psikologjik/psikiatrik. Ky grup të ndaluarish nuk do të paraqesë (të paktën, nuk duhet të paraqesë, nëse sistemi i klasifikimit funksionon në mënyrë të kënaqshme) një pjesë të vogël të popullsisë që vuan dënimin. Megjithatë është një grup që shqetëson në mënyrë të veçantë KPT-në, për arsye se nevoja që lind për marrjen e masave të posaçme ndaj tij përmban një rrezik më të lartë për trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar.

Të dënuarit që paraqesin një shkallë rreziku tepër të lartë për sigurinë duhet, brenda rrethimit të njësisë së tyre të ndalimit, të gëzojnë një regjim reletivisht jo tepër të rreptë, të tillë që të kompesojë rreptësinë e situatës së tyre të vuajtjes së dënimit. Në veçanti, ata duhet të kenë mundësi të takojnë të ndaluarit e tjerë në njësinë e tyre dhe të kenë mundësi të zhvillojnë veprimtari të ndryshme. Përpjekje të posaçme duhet të bëhen për të krijuar një atmosferë të mirë brenda njësisë të sigurisë së lartë. Qëllimi duhet të jetë vendosja e marrëdhënieve pozitive midis personelit dhe të dënuarve. Kjo gjë është njëherësh në favor të një trajtimi njerëzor të të ndaluarve, por dhe për mbajtjen e një kontrolli dhe të një sigurie efikase, përfshirë këtu dhe sigurinë e personelit.

Pasja e një programi veprimtarish është po kaq e rëndësishme – ndoshta dhe më tepër – në një njësi sigurie të lartë sesa në një njësi të zakonshme. Një program i tillë mund të bëjë shumë për të penguar pasojat e dëmshme që shkakton mbi personalitetin e një të ndaluarit, jeta në një ambient të kufizuar në një njësi të tillë. Veprimtaritë e propozuara duhet të jenë tepër të ndryshme (edukim, sport, punë me vlerën e një formimi profesional, etj.). Me sa ka të bëjë sidomos me punën, është e qartë që arsyet e sigurisë mund të përjashtojnë shumë tipe punësh që gjehen në një institucion normal për vuajtjen e dënimit. Megjithatë, kjo nuk duhet të nënkuptojë që të ndaluarit të kryejnë vetëm punë të një natyre të mërzitshme.

Kuptohet se një i ndaluar nuk qëndron i nënshtruar ndaj një regjimi të veçantë sigurie më tepër se ç'nevojitet për rrezikun që ai paraqet. Pra, vendimi i klasifikimit duhet të rishikohet rregullisht. Të tilla rishikime duhet të bazohen gjithnjë në një vlerësim të përhershëm të të ndaluarit nga një personel i veçantë i përgatitur për një vlerësim të tillë. Për më tepër, të ndaluarit duhet, aq sa është e mundur, të informohen plotësisht për arsyet e klasifikimit të tyre dhe nëse nevojitet për rinovimin e tij; kjo do t'u lejojë atyre kryesisht përdorimin e rrugëve të rekursit ndaj kësaj mase.

---

<sup>2</sup> Shih gjithashtu “Shërbimet shëndetsore në burgje”, seksioni “sëmundje ngjësore”.

## **Të dënuarit me burgim të përjetshëm dhe të tjerë që vuajnë dënime të gjata**

33. Në disa vende europiane, numri i të ndaluarve që vuajnë burgimin e përjetshëm dhe i të ndaluarve të tjerë që vuajnë dënime të gjata është në rritje. Gjatë disa vizitave, KPT-ja ka konstatuar se situata e këtyre të dënuarve linte shumë për të dëshiruar në nivelin e kushteve materiale, të programeve të veprimtarive dhe të mundësive të kontakteve njerëzore. Përveç kësaj shumë të dënuar i nënshtroheshin kufizimeve të veçanta të cila ishin të një natyre që i rrisnin pasojat e dëmshme që shoqëroheshin nga një burgim afatgjatë; shembuj të këtyre kufizimeve janë ndarja e përhershme nga të dënuarit e tjerë, prangosja e të dënuarit për çdo nxjerrje nga qelia, ndalimi i komunikimit me të ndaluarit e tjerë dhe kufizimi i të drejtave për vizita. KPT-ja nuk shikon asnjë justifikim për zbatimin pa dallim për të gjithë të dënuarit të ngarkuar me një lloj të veçantë dënimi, pa marrë parasysh rreziqet që ata mund (ose nuk mund) të paraqesin individualisht.

Çdo burgim me afat të gjatë mund të shkaktojë mbyllje në vetvete tek të dënuarit. Përveç faktit që ato institucionalizohen, të dënuar të tillë mund të preken nga një seri problemesh psikologjike (si humbja e vlerësimit të vetëvehtes dhe shkatërrimi i aftësive shoqërore) dhe tentojnë të shkëputen sa më shumë nga shoqëria drejt së cilës pjesa më e madhe e tyre do të rikthehen përsëri. Sipas mendimit të KPT-së, regjimet që i propozohen të dënuarve që vuajnë dënime të gjata duhet të kompesojnë pasojat në mënyrë pozitive dhe vepruese.

Të dënuarit e interesuar duhet të kenë mundësi për të kryer veprimtari të ndryshme dhe motivuese (preferohet puna me vlerë për formimin profesional; studimet; sporti; dëfrimet/aktivitetet e përbashkëta). Për më tepër ata duhet të kenë mundësi të zgjedhin mënyrën e kalimit të kohës së tyre, gjë që do të stimulonte autonominë e tyre dhe përgjegjësinë personale. Masa plotësuese duhet të merren për t'i dhënë një kuptim burgimit të tyre; më saktësisht, parashikimi i trajtimeve të personalizuar dhe një mbështetje psikosociale e përshtatshme janë të rëndësishëm për të ndihmuar këta të dënuar për të përballuar burgimin e tyre dhe, kur vjen koha, për lirim të tyre. Për më tepër, pasojat negative të izolimit tek të dënuarit që vuajnë dënime afatgjata do të lënë më pak gjurmë dhe ata do të jenë të përgatitur më mirë për lirim të tyre, nëse ata kanë efektivisht mundësinë për të qëndruar në kontakt me botën e jashtme.